



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2020:001743

Datë: 25.03.2021

Numri i dokumentit: 01632810

**PKR.nr.300/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda,** Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët: Mentor Hajraj dhe Radosllav Markoviq, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.B nga fsh.... Komuna e Mitrovicës për veprën penale Mbajtja në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.II.nr.4077/2018 e dt.03.02.2020, shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prezencën e palëve Prokurorit të Shteti në PTH Mitrovicë Njazi Rexha, të akuzuarit E.B, seanca ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19, pas përfundimit të shqyrtimi gjyqësor më dt.22.03.2021 Gjykata ka shpallur publikisht aktgjykimin ndërsa me dt.25.03.2021 ka përpiluar me shkrim këtë:

**AKTGJYKIM**

**I akuzuari: E.B,** nga i ati Z., e ëma V., e gjinisë D., i lindur me dt...., me numër personal ..., me vendbanim në rr. "...” në fsh.... Komuna e Mitrovicës, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

Nga koha e pavërtetuar e deri me dt.20.12.2016, i pandehuri ka mbajtur në posedim armën Ekol Special 99 me numër serik EV-12123771 e kalibrit 9mm e cila armë fillimisht ka qenë e dizajnuar për fishek të kalibrit 9mm Gas, mirëpo armës i është adoptuar-konventuar tyta (duke i vendosur tytë me vaska, e punuar me dorë) në mënyrë që të shkrep fishek të kalibrit 7.65x17mm me mbushje të barotit dhe në këtë mënyrë arma është bërë armë e zjarrit dhe ka funksionuar si e tillë, dhe një karikator të zbrazët të së njëjtës armë me kapacitet prej 9 fishek të kalibrit 7.65x17 mm, në kundërshtim me nenin 4 par.1 pika 1.1 nën pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L-022), armë e cila është sekuestruar nga ana e policisë.

**Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 46, 62, 69, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së të akuzuarit i:

**SHQIPTON**

**I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400€(katërqind euro),** të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast së i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim duke llogaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë të kaluar në burg.

**II.** Gjykata në mbështetje të nenit 62 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 69 par.1 e 2 të KPRK-së, e lidhur me nenin 282 par.1 e 2 nën par.2.1 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton **DËNIM PLOTËSUES**, Konfiskimi i sendit – armës Ekol Special 99 me numër serik EV-12123771 e kalibrit 9mm dhe karikatorit të së njëjtës armë, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se arma është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m i**

### **Aktakuza**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4077/2018 e dt.03.02.2020, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, ndaj të pandehurit E.B i akuzuar për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me 1 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni penal, duke u bazuar në dispozitat e nenit 22 par.1 pika 1.75 të KPP-së, e ka veçuar procedurën sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së në pikën II të Aktakuzës PP.II.nr.4077/2018 e dt.03.02.2020 dhe këtë çështje penale me datën 27.07.2020, e ka deleguar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda për shqyrtim dhe vendosje, për shkak të kompetencës lëndore lidhur me këtë vepër penale.

### **Rrjedha e procedurës**

Më datë 02.11.2020 Kryetari i trupit gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale ndaj të akuzuarit E.B, seanca ishte mbajtur në prezencën e të akuzuarit dhe Prokurorit të Shtetit Ismet Ujkani.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari është deklaruar mbi fajësinë. I akuzuari në këtë rast e ka mohuar fajësinë në lidhje me veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet dhe pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar me të drejtat e tij duke i dhënë afatin ligjor për paraqitjen e kundërshtimit ndaj aktakuzës dhe provave.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor i akuzuari ka paraqitur kundërshtime ndaj aktakuzës dhe provave, ku Gjykata me Aktvendimin PKR.nr.300/2020 të dt.14.12.2020, ka refuzuar si të pa bazuar kundërshtimin e paraqitur nga i akuzuari ndaj Aktakuzës, ndaj këtij Aktvendimi i akuzuari nuk ka ushtruar ankesë dhe si i tillë është bërë i plotëfuqishëm.

### **Shqyrtimi gjyqësor**

Me datë 22.03.2021, Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në prezencën e të akuzuarit dhe Prokurorit të Shtetit Njazi Rexha, në seancë kanë prezentuar dëshmitarët Xh.D, K.B dhe M.Z, seanca ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19.

**Dëgjimi i dëshmitarëve dhe administrimi i provave materiale**

Në cilësi të dëshmitarëve me dt.22.03.2021 në seancën e shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar Xh.D, K.B dhe M.Z, të propozuara nga Prokurori i Shtetit.

Po me të njëjtën datë në seancën e shqyrtimit gjyqësor në cilësi të provave materiale në janë administruar:

- *Deklarata e dëshmitarit K.B e dhënë në Polici me dt.03.06.2016;*
- *Deklarata e dëshmitarit M.Z e dhënë në Polici me dt.03.06.2016;*
- *Vërtetimin mbi marrjen e sendeve me nr.2016-BC-1399 i dt.21.12.2016;*
- *Raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit Xh.D të dt.21.12.2016 me nr.rendor 22066;*
- *Procesverbali mbi egzaminimin e pranisë së alkoolit në organizëm në emër të dëmtuarit Xh.D me nr.2016-BC-1399 i dt.21.12.2016;*
- *Akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë në emër të të dëmtuarit Xh.D me nr.referencës 18/2019 i dt.21.12.2019;*
- *Njoftimi mbi rezultatin e kërkimit në sistemin IBIS nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. reference 2017-3540-SI i dt.05.11.2018;*
- *Fotoalbumin në shkresat e lëndës me nr.2016-BC-1399 i dt.21.12.2016.*

***Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.22.03.2021, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Xh.D,*** i cili ka deklaruar se atë ditë e kam pasur në ditë të gëzuar, për shkak se kam dëgjuar se bashkëshortja është shtatëzënë por festimi mu kthye në idhnim, atë ditë kam përdorur alkool, unë përbrenda stacionit e kam një lokal-kiosk dhe në lokalin tim kam përdorur pije alkoolike birrë-Llashku pasi që morra lajmin se bashkëshortja është shtatëzënë, mbasi e kam mbyllur kiosken kam shkuar në lokalin R. në mbrëmje dikun rreth orës 22 apo 23, aty kam përdorur pije dhe kam vallëzuar, në ato momente kam shkuar në wc, ka ardhur një person i cili më ka shtyer por që nuk është këtu, unë kam qenë nën ndikimin e alkoolit, jam përta me të dhe kam dalur jashtë, isha në pozitë duke ndenjur duke brohoritur dhe fishkëlluar, ndërsa në atë moment ka ardhur ky personi që unë e njoh me nofkën “T.” që drejtohet në drejtim të pandehurit E.B në seancë, deklaroi se emrin nuk ja di përveq pseodonimit, më ka goditur me hekur apo revole qka ka qenë ajo, me ka goditur në kokë, kam pasur lëndime në kokë dhe i kam shejat, tani kemi pasur edhe shtyrje mes veti ku ka ardhur edhe sigurimi, unë nuk e di ku e ka marrë revolen përveq kur e kam dëgjuar goditjen në kokë, për pak sekonda nuk e kam ditur se ku jam, më vjen keq qka ka ndohur atë natë, nuk është dashur të ndodhë, më herët nuk i kam parë armë kurr dhe nuk kam pasur kontaktë me të pastaj, e frekuentoj shpesh lokalin R. për ndonjë gëzim për të konsumuar alkool, jam njeri i lumtur i gëzuar, si i dëmtuar ka deklaruar se nuk parashtroj kërkesë pasurore juridike.

***Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.22.03.2021, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar K.B,*** i cili ka deklaruar se unë kam qenë në fund të sallës duke shërbyer, unë qka kam parë aty kallabllak, ishin rrethur mes vete menaxheri E. dhe ai personi me nofkën “Xh.”, i njëjti vjen shpesh në lokal po thuajse qdo mbrëmje, ka bërë probleme vazhdimisht, ka thyer shpesh mbrenda lokalit, unë nuk kam qenë në fund të sallës së gjatë, unë nuk kam parë armë në dorë ndokujt apo menaxherit tim, tani nuk punoj në atë lokal, emrin menaxheri e ka pasur E. me nofkën “T.”, prej vitit 2016 nuk kam punuar në atë lokal, policia ka ardhur kur ka përfunduar rasti, mendoj pas një ore, nuk e di a ka marrë diqka aty.

***Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.22.03.2021, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar M.Z,*** i cili ka deklaruar se atë ditë kam qenë në punë, data e saktë nuk më kujtohet, edhe atëherë kur kam deklaruar unë kam punuar si kamarier, Xh. ka ardhur pothuajse qdo natë, atë ditë unë kam qenë duke shërbyer, salla ka qenë plotë, muzika me zë të lart, kur jam kthyer e kam parë një

tollovi dhe i kam marrë pijet për të shërbyer, më vonë thanë që kanë pasur mosmarrëveshje E. me Xh.-Xh., nuk kam parë armë tek asnjë person, dhe as përpara nuk kam parë armë tek E., policia e kanë kontrolluar me dritat elektrike vendin mirëpo jo musafirët prezent, nuk kanë gjetur diçka në vendin e ngjarjes.

### **Marrja në pyetje e të akuzuarit**

Me 22.03.2021 në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari E.B ka paraqitur mbrojtjen e tij në lidhje me këtë rast.

Në mbrojtjen e tij i akuzuari ka potencuar faktin se me dt.21.12.2016 policia e ka sekuestruar një pistoletë nga ai dhe se armën vet personalisht i ka dorëzuar policisë, konkretisht armën Ekol Specila 99 Gas si në Fotoalbum pasi që i është dhënë në vështrim Fotoalbumi i bërë nga ana e Policisë dhe i akuzuari e ka pranuar faktin se armë në foto j'a ka dorëzuar policisë, ka theksuar faktin se nuk ka poseduar leje për armë, ka punuar si menaxher në lokal "R.", ka theksuar faktin se arma nuk ka qenë e tij pasi që në lokal ka pasur shumë persona dhe se nuk e dinë e kujna ka qenë, armën j'a ka dorëzuar policisë për shkak se me të njëjtën e ka goditur Xh., armën e ka marrë nga "shanku" në lokal, kur i ka dorëzuar armën policisë ka pohuar faktin se e ka nënshkruar vërtetimin mbi sekuestrimin e armës, ka theksuar se prej momentit që ka ndodhur përleshja me Xh. e deri kur kanë ardhur policia ka kaluar rreth një orë apo një orë e gjysmë dhe gjatë kësaj kohë arma ka qëndruar në "shank" dhe armën askush nuk e ka kërkuar, ka qenë afër përfundimi i mbrëmjes andaj edhe musafirët janë larguar.

### **Fjala përfundimtare**

Me datë 22.03.2021 palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave rezulton se i pandehuri E.B ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet në aktakzë, nuk është kontestuese se me dt.21.12.2016 në rr.Mbretëresha Teutë në Mitrovicë në lokal "R." ka pasur konflikt në mes menaxherit të lokalit tani të pandehurit Xh.D me crast kanë intervenuar policia dhe në këtë lokal është sekuestruar pistolet Ekol Special 99 me nr. serik EV 12123771 e kalibrit 9 mm, i adaptuar gjegjësisht konvertuar tyta në mënyrë që të shpreh fishek të kalibrit 7.65x17 mm., me mbushje baroti, e që vërtetohet edhe nga raporti i ekspertizës së AKF-së, po ashtu nga vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt.21.12.2016 rezulton se nga i pandehuri E.B është marrë pistolet Ekol Special me një karikator dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri nuk e mohon faktin se policia ka marrë pistoletën në fjalë dhe të cilën e ka dorëzuar vet e për të cilën pistoletë nuk ka poseduar leje mirëpo nuk pranon faktin se pistolet ka qenë e tij duke u arsyetuar se dikush prej musafirëve të pranishëm ka lënë pistoletën në shank, një mbrojtje e tillë e të pandehuri është e pabazë, e paargumentuar e drejtuar nga shmangja e përgjegjësisë penale, me vet faktin se pistolet është gjetur në shank të cilin lokal e ka menxhuar i pandehuri, se i pandehuri e ka nënshkruar vet vërtetimin mbi sekuestrimin e armës vërteon se arma ka qenë në pronë të tij, andaj i propozoj gjykatës që ta pandehurin ta shpallë fajtor dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

I akuzuarit në fjalën përfundimtare ka deklaruar sa i përket armës nuk ka qenë e imja dhe nuk ndiej fajtor, kam qenë menaxher i lokalit dhe armën e kam gjetur në shank dhe e kam marrë në momentin kur kemi pasur mosmarrëveshje me Xh., armën e kam dorëzuar vet policisë dhe i kam treguar për rrethanat si ka ndodhur rasti, andaj nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale të armëmbajtjes siç deklarova më lart, nga ai moment i ndodhjes së rastit më nuk kam punuar në atë lokal sepse nuk është në natyrën time që të ballafaqohem me probleme, tani për tani jam i papunë, kërkoj që të lirohem nga kjo aktakzë.

### **Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor dhe shpallja publike e aktgjyqimit**

Më datë 22.03.2021, trupi gjykues e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale dhe po në të njëjtën ditë në mungesë të të akuzuarit dhe të Prokurorit të Shtetit ka shpallur publikisht aktgjykimin.

### **Gjetjet e gjykatës në raport me rrethanat e gjendjes faktike**

#### **Faktet jokontestuese**

Faktet në vijim nuk kanë qenë kontestuese:

- I akuzuari ka punuar si menaxher në lokalin “R.” në kohën e ndodhjes së ngjarjes me dt.21.12.2016.
- I dëmtuarit-dëshmitari Xh.D ditën kritike ka qenë në lokalin “R.”si musafir-klient.
- I dëmtuari-dëshmitari Xh.D ditën kritike ka qenë nën ndikimin e alkoolit prej 2.67 g/kg.
- I akuzuari në ditën kritike me dt.21.12.2016 e ka goditur në kokë të dëmtuarin-dëshmitarin Xh.D me kondakun e armës Ekol Special 99 Gas me numër serik EV-12123771, pas një konfliktit fizik që e kanë pasur mes vete dhe i ka shkaktuar lëndime trupore.
- I akuzuari me dt.21.12.2016, i ka dorëzuar Policisë armën Ekol Special 99 Gas me numër serik EV-12123771, me të cilën e ka goditur të dëmtuarin Xh.D.

Faktet e lartcekura nuk ishin kontestuar nga i akuzuari, përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktin se i akuzuari ka qenë menxher në lokalin “R.” në kohën e ndodhjes së ngjarjes në ditën kritike e ka pohuar vet i akuzuari gjatë gjithë fazave të procedurës penale, po ashtu këtë fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët K.B dhe M.Z të cilën kanë punuar si kamarier në lokalin “R.”.

Faktin se i dëmtuari-dëshmitari Xh.D ditën kritike ka qenë në lokalin “R.” si klient dhe ka konsumuar alkool e ka pohuar vet i dëmtuari-dëshmitari e këtë fakt e kanë pohuar edhe i akuzuari së bashku me dëshmitarët e tjerë, ndërsa faktin se i dëmtuari dëshmitari Xh.D ka konsumuar alkool vërtetohet edhe në bazë të Procesverbalit mbi egzaminimin e pranisë së alkoolit në organizëm me nr.2016-BC-1399.

Faktin se ka pasur konflikt fizik mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit-dëshmitarit Xh.D nuk e kanë mohuar në asnjë fazë të procedurës penale i akuzuari dhe i dëmtuari Xh., e po ashtu faktin se i akuzuari e ka goditur me kondakun e armës të dëmtuarin Xh. vërtetohet nga vet deklaratimet e të akuzuarit si dhe nga provat që janë pjesë përbërëse e lëndës siç janë Raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit Xh.D të dt.21.12.2016 me nr.rendor 22066 si dhe Akt ekspertimi mjekoligjor në bazë në emër të të dëmtuarit Xh.D me nr.referencës 18/2019 i dt.21.12.2019, po ashtu fakti se i dëmtuari-dëshmitari Xh.D ka qenë nën ndikimin e alkoolit vërtetohet nga Procesverbali mbi egzaminimin e pranisë së alkoolit në organizëm në emër të dëmtuarit Xh.D me nr.2016-BC-1399 i dt.21.12.2016 dhe atë 2.67 g/kg.

Faktin se i akuzuari i akuzuari i ka dorëzuar armën Policisë dhe atë armën Ekol Special 99 Gas me numër serik EV-12123771, vërtetohet nga vet deklarimi i të akuzuarit e po ashtu nga Vërtetimin mbi marrjen e sendeve me nr.2016-BC-1399 i dt.21.12.2016.

Bazuar në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor të cekura si më lart, vërtetohen faktet e lartcekura, andaj për Gjykatën faktet e tilla nuk kanë qenë kontestuese dhe janë provuar përtëj çdo dyshimi.

**Në këtë çështje penale kontestues ka qenë fakti se i akuzuari E.B a e ka pasur armën në posedim të paligjshëm?**

I akuzuari gjatë marrjes në pyetje në Polici po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka mohuar faktin se ditën kritike gjatë konfliktit fizik me të dëmtuarin Xh. të njëjtin e ka goditur me kondakun e armës në kokë dhe po ashtu nuk e ka mohuar faktin se armën j'a ka dorëzuar vet personalisht policisë. Po ashtu i akuzuari ka potencuar faktin se ditën kritike pas që e ka goditur me kondakun e armës të dëmtuarin Xh. e ka pritur rreth një orë apo një orë e gjysmë policinë për t'i dorëzuar armën dhe se armën pas konfliktit e ka vendosur në "shank" deri sa ka ardhur policia.

I akuzuari gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar fajësinë lidhur me veprën penale me arsyetimin se i njëjti ka qenë vetëm menaxher i lokalit "R." dhe se armën e ka gjetur në "shank" duke e marrë armën në dorë vetëm në momentin kur e ka goditur të dëmtuarin me të dhe se i njëjti sipas deklaramit të tij nuk është fajtor sa i përketë armëmbajtjes pa leje.

Gjykata duke u mbështetur në deklaramin e vet të akuzuarit po ashtu në provat që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës ka arritur të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka konsumuar elementet e veprës penale Mbajtja në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Fillimisht Gjykata sqaron faktin se si veprimet e kryerjes së veprës penale nga ky nen janë në mënyrë alternative dhe kryhet nga kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armë. Për Gjykatën në rastin penal konkret nuk ka qenë çështje shqyrtuese pronësia e armës sepse sipas përshkrimit faktik në dispozitiv të Aktgjykimit i akuzuari nuk është dyshuar për pronësi të paautorizuar të armës mirëpo për posedimin faktik të saj.

Elementet e veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, konkretisht veprimi i kryerjes së veprës nga mbajtja në pronës të armës në mënyrë të paligjshme konsumohet me rastin kur kryesi i veprës penale është pronari i armës dhe atë e mban në mënyrë të paautorizuar, e që sipas dispozitave ligjore në fuqi konkretisht LIGJIT Nr.05/L-022 PËR ARMË në mënyrë specifike parashihen llojet e armëve për të cilat kërkohet leje dhe si të tilla personi i cili në mënyrë të përcaktuar ligjore merr lejen e caktuar për posedimin e armës mund të bëhet pronari ligjor i armës përderisa atë e blenë sipas procedurave ligjore në fuqi lidhur me shitblerjen e armëve, kurse nëse i njëjti nëse thyen rregullat e përcaktuara sipas këtij ligji lidhur me rastin e mbajtjes së saj në cilësinë e pronarit ku në mënyrë të paautorizuar e mban armën atëherë konsumohet veprimi i kryerjes së veprës penale në këtë formë, pra kur ekziston pushteti juridik dhe faktik mbi armën, i njëjti sipas përshkrimit faktik është akuzuar për posedim të paautorizuar të armëve e që për Gjykatën është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka konsumuar elementet e veprës penale në rastin konkret konkretisht ka ndërmarrë veprimin e kryerjes-posedimin e paautorizuar të armës.

Gjykata sqaron se veprimi i kryerjes së veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së konkretisht posedimi i paautorizuar i armës konsumohet me rastin kur kryesi ka pasur pushtetin faktik mbi armën, pasi që "posedimi" nënkupton pushtetin faktik mbi sendin pa pushtetin juridik, e që në rastin konkret bazuar në deklaramin e vet të akuzuarit i njëjti në asnjë fazë të procedurës penale nuk e ka mohuar faktin se armën e ka pasur në posedim dhe atë që nga momenti që e ka goditur të dëmtuarin me kondakun e saj në kokë dhe deri sa kanë ardhur policia kjo pasi që vet i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka theksuar faktin se "e dorëzova (bëhet fjalë për armën) për shkak se me të njëjtën e kam goditur Xh...." dhe po ashtu i njëjti ka deklaruar se "arma ka qëndruar tek shanku" pra bëhet fjalë pas momentin që e ka goditur të dëmtuarin, i akuzuari armën e ka vendosur prapë në "shank" aty ku dhe e ka marrë dhe e ka pritur policinë deri sa kanë ardhur për t'i dorëzuar armën.

Gjykata gjenë se i akuzuari me veprimet e tij dikën kritike ka konsumuar veprimi e kryerjes së veprës penal konkretisht posedimin e paautorizuar të armës pasi që i njëjti me kondakun e armës së lartcekur si në këtë Aktgjykim e ka goditur të dëmtuarin në kokë duke bërë edhe veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së (për të cilën vepër penale është duke e shqyrtuar Departamenti i Pëgjithshëm pranë kësaj Gjykate) dhe se armën e ka vendosur prapë në “shank” deri sa kanë ardhur policia. Pikërisht ky fakt se i njëjti ka pasur armën në dorë e konsumon veprimin e posedimit të paautorizuar të armëve e për më tepër ky veprim konsumohet edhe me rastin kur i akuzuari e ka vendosur armën prapë në “shank” deri sa ka ardhur policia duke pasur posedimin faktik mbi armën pasi që i njëjti e ka mbajtur armën dhe se askush tjetër nuk ka pasur kontakt me armën deri në ato momente, e që në këtë rast gjatë kësaj periudhe kohor i akuzuari ka konsumuar veprimin e kryerjes së veprës penale posedimi i paautorizuar i armës pasi që i njëjti ka pasur pushtetin faktik mbi armën dhe atë në mënyrë të paautorizuar pasi që nuk ka pasur lejen përkatëse për posedim të armës sipas ligjeve në fuqi.

Pretendimi i të akuzuarit se i njëjti nuk ka qenë pronar i armës për Gjykatën nuk është i rëndësishëm pasi që tek vepra penale Mbajtja në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, nuk parashihet që të plotësohet në mënyrë komulative veprimet e kryerjes së saj por në mënyrë alternative pasi që mjafton vetëm njëri nga veprimet e kryerjes të konsumohet në mënyrë që të plotësohen elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata, në bazë të të gjitha provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i akuzuari E.B ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

### **Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit**

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethanë lehtësuese Gjykata ka marrë për bazë rrethanat personal të të akuzuarit se i njëjti është mbajtës i familjes, i pa punë ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata ka marrë për bazë dashjen e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale andaj gjykata në vlerësim të rrethanave të theksuara si më lart i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepër tjetër penal, e andaj Gjykata nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të akuzuarin.

### **Lidhur me konfiskimin**

Gjykata si nën pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit, të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimin e sendit - armës Ekol Special 99 me numër serik EV-12123771 e kalibrit 9mm dhe karikatorit të së njëjtës armë, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 pika 1.1 nën pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L-022), Gjykata duke marrë për baze sigurinë juridike po ashtu është sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet me lart, kjo në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nën par.2.1 të KPP-së, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh gjetjet e gjykatës lidhur me fajësinë apo

pafajësinë e të akuzuarit, e lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK-së, përcakton “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”, andaj për shkaqe ligjore të konstatuara me lart gjykata ka vendos si nën pikën II të këtij Aktgjykimi, që sendet e përdorura të merren –konfiskohen.

**Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale**

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

**Lidhur me kërkesën pasurore juridike**

Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lart duke u bazuar në nenin 365 të KPP-ës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË  
Departamenti për Krime të Rënda  
P.nr.300/2020 dt.25.03.2021**

**Procesmbajtësi  
Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Bekim Veliqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për Gjykatë.